KUVENDI
NR 2114/1 DATE 07.07.23

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**
**DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË INSTITUCIONEVE QENDRORE**

Nr 613/10. Prot

Tiranë, më 06 07.2023

**M I R A T O H E T**

**K R Y E T A R**

**Arben SHEHU**

# PROGRAM AUDITIMI
# NË
# KUVENDIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

| | |
|---|---|
| **Objekt i auditimit:** | *Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e evaduara në 6-mujorin e dytë të vitit 2022.* |
| **Lloji i auditimit:** | Verifikim i zbatimit të rekomandimeve. |
| **Objektivat e Auditimit:** | Respektimi i afateve dhe ecuria e zbatimit të rekomandimeve |
| **Qëllimi i auditimit:** | Të vlerësojë nivelin e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimet e mëparshme, koherencën e tyre dhe përgjegjshmërinë menaxheriale referuar standardeve të auditimit. |
| **Metoda e auditimit:** | Auditim i plotë |
| **Dokumentimi i rezultateve të auditimit** | Në përfundim të auditimit, mbi bazën e të dhënave të rezultateve të auditimit: grumbulluara, shqyrtimit të komenteve dhe shpjegimeve të subjektit të audituar do të përgatitet Projekt Raporti i Auditimit, i cili do të jetë materiali bazë për hartimin e Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe rekomandimet për përmirësimin e gjendjes. |
| **Kontrolli i Cilësisë:** | Realizohet sipas Rregullores së Procedurave të Auditimit, miratuar me vendimin e Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit nr.107, dt. 08.08.2017 *"Për miratimin e Rregullores së Procedurave të Auditimit në Kontrollin e Lartë të Shtetit"* si dhe |

| | |
|---|---|
| | Udhëzimit të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit nr.67 datë 23.06.2020 "*Manual Për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të auditimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe Regjistri elektronik institucional*". |
| **Afati i auditimit:** | 07.07.2023 deri në 31.07.2023 |
| **Grupi i auditimit:** | Znj. Almida Kafia përgjegjës grupi, Znj. Ana Xhabrahimi, Z. Jon Kraja, Z. Grigor Prifti dhe Z. Spiro Kuro anëtarë. |

**I. Baza Ligjore për kryerjen e auditimit:**

| Lloji Dokumentit | Detajet e bazës ligjore dhe rregullatorë që do të përdoret |
|---|---|
| **Referenca me Standardet e Auditimit** | Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI) të INTOSAI-t;<br>Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ( ISA) të IFAC;<br>Praktika të mira të fushës si: Manuali i Auditimit të Përputhshmërisë të Gjykatës Evropiane të audituesve;<br>Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t, INTOSAI "Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit;<br>ISSAI mbi Auditimin e përputhshmërisë";<br>Manuali për Ndjekjen e Zbatimit të Rekomandimeve të Auditimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit, miratuar në Kontrollin e Lartë të Shtetit; Rregullat; Udhëzimet e KLSh-së etj. |

**I. Drejtimet kryesore të auditimit:**

Drejtimet kryesore sipas të cilave do të zhvillohet veprimtaria audituese janë si më poshtë:

1. Hartimi i programit (plani i veprimit). Respektimi i afateve ligjore për njoftimin e KLSH për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afateve të përcaktuara në Ligjin nr.154/2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit".

2. Zbatimi i rekomandimeve *për përmirësimin në legjislacionin në fuqi*. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: sa rekomandime janë pranuar dhe nga këto sa rekomandime janë zbatuar plotësisht, sa janë zbatuar pjesërisht, sa janë në proces zbatimi dhe sa rekomandime nuk janë zbatuar.

3. Zbatimi i rekomandimeve *për masat me karakter organizativ*. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: sa rekomandime janë pranuar dhe nga këto sa rekomandime janë zbatuar plotësisht, sa janë zbatuar pjesërisht, sa janë në proces zbatimi dhe sa rekomandime nuk janë zbatuar.

4. Zbatimi i rekomandimeve *për shpërblim dëmi ekonomik*. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: sa rekomandime janë pranuar dhe nga këto sa rekomandime janë zbatuar plotësisht, sa janë zbatuar pjesërisht, sa janë në proces zbatimi dhe sa rekomandime nuk janë zbatuar.

5. Zbatimi i rekomandimeve *për përdorimin me efektivitet dhe ekonomicitet*. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: sa rekomandime janë pranuar dhe nga këto sa rekomandime

janë zbatuar plotësisht, sa janë zbatuar pjesërisht, sa janë në proces zbatimi dhe sa rekomandime nuk janë zbatuar.

7. Zbatimi i rekomandimeve *për masa disiplinore dhe administrative*. Fillimi i procedurave për dhënien e masave disiplinore dhe administrative. Sa rekomandime janë pranuar dhe ecuria e tyre për masat e dhëna

8. Të tjera që rezultojnë gjatë auditimit.

**Përgjegjësi i Grupit të Auditimit**
**Almida KAFIA**

**Drejtori i Departamentit**

**Kozma KONDAKÇIU**